

**AKT - THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË “Progress Construction Company 2020 ” SH.P.K**

Ne Tirane sot më datë 23.02.2020 ne baze dhe per zbatim te Ligjit Nr. 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723 date 3.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”i ndryshuar, unë themeluesi i vetëm **Kristi Kana**,i biri i Spiro dhe Eli, lindur më datë 12.06.1984 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Leternjoftimit ID me Nr. personal I40612003P , vendosa te themeloj Shoqërine me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Progress Construction Company 2020” SH.P.K, me kohëzgjatje të pacaktuar dhe me seli kryesore në adresën Rruga: “Bardhok Biba”, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 1**

**Forma Ligjore dhe Emërtimi**

Shoqëria krijohet në formën e *shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar* me emër “Progress Construction Company 2020” SH.P.K. (“Shoqëria”).

**Neni 2**

**Selia**

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën, *Rruga: “Bardhok Biba”, Tirana Old Building, Kati I, Tiranë, Shqipëri.*

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë:**

- Projektimin dhe ndertimin e ndertesave per banim si dhe tregetimin e tyre. Projektim dhe ndertim rruges, vepra te ndryshme industriale, ndertime ne fushen e bujqesise etj. Ndertimi i sinalistikes rrugore jo ndriçuese, barriera e mbrojtje rrugore. Blerja, shiitja, dhenia me qera, nenqira e pasurive te paluajtshme, dhenia me qera e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme te shoqerise, duke respektuar dispozitat e ligjit ne fuqi. Prodhim te artikujve te ndryshem qe perdoren ne fushen e ndertimit si beton, inerte, mermer etj, si dhe tregetimin e tyre. Rikonstruksion godinash civile, ekonomike, industriale, veshje fasadash etj. Ndertim Ujesjelles-Kanalizime, gazsjelles, ndertim vepra kullimi, ujitje etj.
- Ndertim, zgjerim, modernizim, rikonstruktim, ndertim, projektim, instalim dhe mirembajtje per llogari private, shoqeri, ente te administrimit publik te sistemeve teknologjike dhe ne veçanti te sistemeve elektrike, telefonike, elektromekanike, sisteme te telekomunikacionitajrore dhe me kavo, sisteme te trasmetimit te te dhenave, sisteme te

kondicionimi, sisteme hidrike, sisteme termohidraulike, sistem engrohje, sisteme ajrimi, sisteme gazi, sisteme kunder zjarrit dhe pastrimi, sisteme te pajisjeve akustike, sisteme te furnizimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, stacione monitorimi, sisteme te lidhjes me fibra optike, sisteme te radiokomunikimit, hartimin e hartave dixhitale, ndertim, projektim, instalim dhe mirembajtjen e kabllove dhe perçuesve nentokesore, linjave elektrike ne lartesi.

- Blerje, shkembim, shitje, qera dhe forma te tjera te biznesit imobilare.
- Ndertim, rikonstruktim, transferim, mirembajtje, shembje, kompletim dhe perfundim te ndertesave per jetese, per veprimtari industriale dhe tregtare, per sherbime bujqesore ose per sherbime te tjera ne pergjithesi, ose per llogari te te treteve, ose me te trete. Ndertim impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri e mirembajtjen e tyre.
- Ekzekutim te te gjitha puneve qe lidhen me aktivitetin e ndertimit siç mund te jene punime te levizjes se tokes ose nentokesore, ndertim muresh edhe me çimento te perforcuar te tipit aktual punime te shembjes, punime rruges , punime te rikonstruktimit te veprave hidrike, gazi dhe elektrike. Punime rikonstrukturimi, riorganizim te ndertesave ne terei ose ne nje pjese te tyre. Punime rifiniture me materiale druri, plastike e xhami dhe te natyres teknike ndertuese.

## **Neni 5**

### **Kapitali Themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mije) Lekë.
- 5.2 Kapitali zoterohet nga ortaku i vetem Z.Kristi Kana , i cila zoteron 1 kuotë të kapitalit themeltar, me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mije) Lekë, që përbën 100% të kapitalit.

## **Neni 6**

### **Transferimi i pjesëve të kapitalit**

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

## **Neni 7**

### **Administratorët**

7.1. Me këtë akt emërohet Administrator i Shoqërisë “Progress Construction Company 2020” SHPK:- **Kristi Kana**.

7.2. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit, sipas përcaktimeve të Statutit dhe ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 (i ndryshuar) për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

7.3. Administratori është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, si edhe ka të drejtë t’ia delegojë kompetencat e tij personave të tretë.



**Neni 8**  
**Dispozita të tjera**

Ky akt themelimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë origjinale, me të njëjtën vlerë ligjore, në gjuhën shqipe.

**THEMELUES**

**Kristi Kana**

